




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Komisioni për ankesa në përbërje, Avdirrahman Sadiku (kryesues i komisionit), Mifail Azizi (anëtar), Fatlum Demiri (anëtar), në mbledhjen e mbajtur me datën 18.05.2023, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës, si: ankesën e OJQ Ansambli i këngëve dhe valleve “Vitia”-Viti, me Nr.12-320/04-19157, e datës 16.05.2023, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-681, i datës 11.05.2023, në përputhje me neni 9 dhe 21 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, komisioni merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazuar** Ankesa e OJQ Ansambli i këngëve dhe valleve “Vitia”-Viti, me Nr.12-320/04-19157, e datës 16.05.2023, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-681, i datës 11.05.2023.
2. **Mbetet në fuqi** Vendimit i listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-681, i datës 11.05.2023.

Arsyetim

Komisioni për ankesa, në mbledhjen e mbajtur me datën 18.05.2023 shqyrtoi ankesën e OJQ Ansambli i këngëve dhe valleve “Vitia”-Viti, me Nr.12-320/04-19157, e datës 16.05.2023, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-681, i datës 11.05.2023 të publikuar nga komisioni prej 5 anëtarëve, me pretendime për pa knaqesin me përkrahjen që i është bërë organizatës ose projekti në lidhje me shumën e ndar, i njëjti e ka kontestuar komisionin si jo adekuat për vlerësimin të projektit, ka kërkuar të shqyrtohet edhe një her mbështetja rreth projektit si dhe ka kontestuar aplikimet që janë bërë në lidhje me atë se ka pas aplikime nga personat e njëjti per dy a po tri projekte etj.

Komisioni i ankesave, bazuar në vlerësimet e hollësishme të çdo prove veç e veç dhe çdo prove së bashku, si dhe bazuar në rezultatet e tërësishme të shqyrtimit administrativ, konstatoj se, ankesa e ankuesit AKV-VITIA, **është e pabazuar**, sepse:

- Kryetari i komisionit për ankesa, Avdirrahman Sadiku, me datën 17.05.2023 ka kërkuar nga anëtarët e komisioni vlerësues dokumentacionet, konkretisht aplikacionin e OJQ Ansambli i këngëve dhe valleve “Vitia”-Viti. Komisioni për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesës, konkretisht ankesës së OJQ Ansambli i këngëve dhe valleve “Vitia”-Viti, me Nr.12-320/04-19157, e datës 16.05.2023, konstaton që, komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve të drejtorisë ka qenë i themeluar konform Rregullores MF – Nr.04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- Komision vlerësues ka qenë i përbërë nga profesionistë të fushës dhe i njëjti ka respektuar neni 4 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve,

konkretisht parimet e përgjithshme, duke respektuar konkurrueshmërinë, trajtimin e barabartë dhe mos diskriminimin e aplikusve, transparenca në procedura e parimet e tjera konform nenit të cekur më lartë.

- Ne konsiderojmë që, komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve, duke vlerësuar e analizuar aplikacionin e OJQ Ansambli i këngëve dhe valleve "Vitia"-Viti, ka vlerësuar drejtë, duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të anëtarëve të kësaj OJQ-je, strukturën e saj, aktivitetet e saj kulturore në të kaluarën si OJQ e nderlidhur me aplikacionin e dorëzuar për përkrahje financiare në lidhje me aktivitetin apo si pjesëmarrës në formë të ndryshme si garuese e forma të tjera. Ne konsiderojmë që, mjetet e ndara për realizimin e projektit për Zija Aliun janë të mjaftueshme dhe komisioni ka vendosur në përputhje me procedurat sipas Rregullorës 04/2017 dhe është në diskrecionin e saj, ndarja e mjeteve për realizimin e projektit në fjalë. Pra, për komisionin e ankesave janë të paqëndrueshme dhe të paargumentuara thëniet në ankesë, sepse vetë thirrja e shpallur ka paraparë se, një OJQ mund të aplikoj në një projekt për secilën nga fushat e thirrjes e në rastin konkret thirrja nuk e ndalon, por as Rregullorja 04/2017 nuk e ndalon që, një person apo i autorizuari i projektit të aplikoj me dy OJQ dhe projekte të ndryshme.

Andaj, mbi bazën e të gjeturave dhe konstatimeve si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, në përputhje me Ligji mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dhe rregullores MF-04/2017, duke pasur parasysh interesin publik dhe ofrimin e mbështetjes për OJQ-të të cilat kontribuojnë në jetën e përditshme kulturore, sportive etj, dhe me qëllim respektimin e ligjshmërisë, financimin përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet, dhe në mënyrë të drejtë dhe transparente, të barabartë me kritere të qarta, duke respektuar dyshkallëshmërinë, parimet e llogaridhënies dhe ruajtjen e pavarësisë së përfituesve, ka ardhë në përfundim dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Vendimi i komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative, andaj palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga data e njoftimit në web faqen e komunës, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi ju dërzohet:

1. OJQ-së ankuese:
2. Komisionit vlerësues:
3. Komisionit të ankesave:
4. Arhivës komunale:

Viti, më 18.05.2023

Avdirrahman Sadiku, kryesues i komisionit

Mifail Azizi, anëtar

Fatlum Demiri, anëtar

